

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-4/09

**Prishtinë
6 maj 2011**

Në procedurën e

S.L., i ashtuquajtur S.S.

Ankuesi

kundër

K.M.N.

Parashtruesi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, dhe Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, në ankesën kundër vendimit të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/13/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA06038), datë 30 prill 2008, pas shqyrtimit të mbajtur më 6 maj 2011 mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e palejueshme ankesa e S.L.,
- 2- Ankuesi, S.L., është i obliguar ti paguaj shpenzimet gjyqësore në shumën prej € 55 (pesëdhjetepesë euro) brenda prej 15 ditëve nga data e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Historiku faktik dhe procedural:

Me 19 Dhjetor 2006 K.M.N. ka paraqitur kërkesë para Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) në lidhje me pronën që gjendet në komunën e Podujevës, në Buricë, zona kadastrale e Surkishit, numri i parcelës 180, e klasës: komerciale pa ndërtim (tokë/pyll); përshkrimi: fushë e klasës së 4-të; në sipërfaqe prej 6746 m². Padia është regjistruar si KPA06038.

Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se ai e ka trashëguar tokën prej babait të tij M.N. dhe se ai nuk e kishte bërë ndryshimin e emrit të pronarit në Zyrën Kadastrale. Për më tepër, ai ka deklaruar se prona i është zënë ilegalisht nga familja e J.L..

Në mbështetje të kërkesës së tij ai i ka siguruar AKP-së dokumentet e mëposhtme:

- fletën poseduese Nr. 17 prej Komunës Kadastrale të Podujevës të datës 24 Shkurt 1988 në lidhje me shtatë prona të ndryshme, e në mesin e tyre edhe prona kontestuese. Fleta si pronar e tregon M.N.;
- vendimin e Gjykatës Komonale të Kurshumlisë, dega në Podujevë, të lëshuar me 12 maj 1998 – II.O.br.36/97- i cili thekson se pas vdekjes së babait të tij në vitin 1985, Parashtruesi i kërkesës e ka trashëguar 1/5 e pjesës ideale të pronës së paluajtshme të babait të tij, në mesin e të cilave ka qenë prona e regjistruar në fletën poseduese Nr. 17 Komuna Kadastrale e Surkishit.

Që të dy vendimet kanë mundur të verifikohen nga ana e AKP-së. Për më tepër AKP-ja ka deklaruar se posedimi është humbur me 10 Qershor 1999 dhe se kjo humbje ka qenë e ndërlidhur me konfliktin.

Me 16 korrik 2007 AKP-ja e ka publikuar njoftimin mbi kërkesën.

Me 8 Mars 2008, zyrtarët e AKP-së kanë shkuar në vendi ku ndodhej palujtshmëria dhe kanë vendosur shenjën që tregonte se kjo pronë ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet ti paraqisnin përgjigjet e tyre brenda një muaji. Prona ishte zënë prej S.L., i cili ishte i pranishëm në pronë, por ka refuzuar ta nënshkruaj njoftimin mbi pjesëmarrjen. Megjithatë, ai nuk ka pretenduar të drejtën ligjore për pronën kontestuese. Një kopje e kërkesës i është lënë z. S.L. dhe B.L..

Duke marr parasysh se brenda periudhës 30 ditore siç parashihet me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr: 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr: 03/L-079 askush nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, kërkesa ka mbetur e pa kontestuar.

Me 30 Prill 2008 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) e ka marr vendimin grupor KPCC/D/A/13/2008 në lidhje me kërkesën, që thekson se “ *parashtruesi i kërkesës ose poseduesi i së drejtës mbi pronën, varësisht nga rasti, e ka vërtetuar pronësinë mbi pronën e pretenduar, ose mbi ndonjë pjesë të saj ashtu siç specifikohet në vendimet individuale përkatëse*”.

Me 21 Nëntor 2008 KKPK-ja e ka identifikuar pronën kontestuese duke deklaruar se: “(a) *Parashtrues-i (it) e kërkesës ashtu siç paraqitet më lartë ka/kanë vërtetuar që K.M.N. është pronari i 1/5 i pronës kontestuese: dhe ka urdhëruar që: (b) K.M.N. [shënim i trupit gjykues: pra parashtruesi i kërkesës] e ka të drejtën e posedimit mbi pronën në fjalë [...]*” KKPK-ja ka theksuar se “ *Në rastet kur ka më shumë së një pronar të pronës kontestuese, vendimi dhe urdhri i mësipërm nuk i prek të drejtat e bashkë/pronarëve përkatës.*”

Me 17 Prill 2009 vendimi i është dorëzuar gruas së S.L..

Me 22 prill 2009 S.L., i identifikuar përmes letërnjoftimit të tij të cilin ai ia ka treguar punëtorit të AKP-së dhe i cili dëshmon se ai me të vërtetë ishte S.L., ka dorëzuar një deklaratë tek AKP-ja duke e përdorur emrin “ S.S.”. Ai ka deklaruar se atij i ka takuar një pjesë e vogël e pronës kontestuese ashtu sikurse edhe 14 familjeve të tjera dhe se ai ishte i gatshëm që të arrij një marrëveshje të drejtë me ata. Ai ka pretenduar se diku 100 vite më parë stërgjyshi i tij, me detyrim nga ana e Serbisë, ishte obliguar ta shiste pronën. Ai nuk dha ndonjë arsye se pse nuk kishte marr pjesë në procedurë para Komisionit.

Arsyetimi ligjor:

I. Ankesa është e palejueshme.

Deklarata e 22 prillit 2009 duhet të interpretohet si ankesë kundër vendimit të KKKPK-së të datës 30 prill 2007 për aq sa ndërlidhet me pronën kontestuese.

Megjithatë, S.L. nuk ka të drejtë të paraqes ankesë. Ankesa kundër vendimit të KKKPK-së mund të paraqitet nga pala në procedurë para KKKPK-së (Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-it Nr: 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079).

S.L. nuk mund të konsiderohet si palë. Palë në kërkesë dhe në procedurat që kanë të bëjnë me kërkesën është *“Çdo person, përveç parashtresit të kërkesës i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe/ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtuar kërkesa[...]me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1.”* (Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-it Nr: 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, e nënvizuar).

S.L. është njoftuar sipas ligjit, megjithatë ai nuk e ka njoftuar Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij për të marr pjesë në procedurë. Sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-it Nr: 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, Sekretaria Ekzekutive *“do ta njoftoj dhe do t'i dërgojë një kopje të kërkesës”* çdo personi i cili aktualisht ushtron të drejtën në pronën e cila është objekt i kërkesës. S.L. është njoftuar për kërkesën në përputhje me rregulloren, me 8 Marsit 2008, kur zyrtarët e AKP-së e vizituan pronën kontestuese, e vendosen shenjën në pronë, e njoftuan për kërkesën dhe i dhanë atij dhe B.L. një kopje të kërkesës. Megjithatë, S.L. nuk e pretendoi të drejtën ligjore mbi pronën brenda periudhës 30 ditore siç parashihet me Nenin 10.2 të Rregullorës së UNMIK-it Nr. 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079. Prandaj, si pasoj e kësaj ai nuk është bërë palë e kësaj kërkesë dhe procedurave që ndërlidhen me këtë kërkesë.

Fakti se atij i u është referuar si “palë përgjegjëse” në raportin e njoftimit dhe se atij i është dorëzuar vendimi i KKKPK-së nuk e ndryshon këtë vlerësim.

Prandaj, duke mos qenë “palë” S.L. nuk ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Për më tepër duhet të theksohet se Neni 10.3 i Rregullorës së UNMIK-it Nr. 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, “*Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdo qoftë gjatë procedurës*”, nuk zbatohet. Ashtu siç u theksua më parë, S.L. e ka marr njoftimin mbi kërkesën.

II. Mirëpo edhe nëse gjykata e ka konsideruar deklaratën një ankesë të vlefshme, ajo është dashtë të refuzohet si e pabazuar për arsyet e më poshtme:

Argumentimi i S.L. nuk mund të merret parasysh. Neni 12.11 i Rregullores së UNMIK-it Nr: 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, përcakton se faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk duhet të pranohen dhe merren parasysh nga Gjykata Supreme përveç nëse dëshmohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Me këtë rast S.L. ishte në dijeni për zhvillimin e procedurës para AKP-së qysh prej 8 marsit 2008, kur zyrtarët e AKP-së e vizituan pronën dhe i dorëzuan atij një kopje të kërkesës. Prapëseprapë ai nuk kishte marrë pjesë në procedurë mirëpo priti deri në marrjen e vendimit të KKPK-së me 17 prill 2009. Ai nuk e ka cekur ndonjë arsye se pse ai nuk e ka dorëzuar arsyetimin e tij në KKPK kundër kërkesës që ishte në procedurë. Po ashtu gjykata nuk mund të shoh ndonjë arsye se pse ai të mos ketë ngritur argumentet e tij në këto procedura ngase faktet e pretenduara duhet të kenë qenë të njohura prej tij.

Duke i pas parasysh faktet e mësipërme dhe në përputhje me Nenin 12.3 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-it Nr: 2006/50 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, Kolegji i Ankesave i AKP-së vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 të Urdhërësës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar nga Ligji Nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që zhvillohet para Sekretariatit Ekzekutiv të Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet edhe për procedurën para Kolegjit të Ankesave.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Ankesave.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Tarifa për shpenzimet gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Gjysmë-tarifa për shpenzimet gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet me arsye prej 5.001 deri në 10.000 €: 25 €.

Këto taksa gjyqësore do të bartën nga ankuesi i cili e humb rastin. Afati i pagesës përshkruhet në Nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazet Zyrtare e KSAJ, 3 tetor 1987).

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nuffer, EULEX Registrar